

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës | Struktura e interesuar/ Forca | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Proçedura e përzgjedhjes së kandidatëve | | Afati i aplikimit | |
|-----|-------------------|----------------------------------|------------------|------------------------------------|---|------------|-------------------|------------|
| | | | | | Me dosje | Intervista | Fillimi | Mbarimi |
| 1 | Specialist BUE | Reparti Ushtarak Nr. 2006 | Durres | Kontratë pune me afat të pacaktuar | Me dosje | | 06.11.2019 | 21.11.2019 |

Formulari nr. 1

| |
|--|
| 1.Pozicioni i punës: Specialist për BUE (Burimet e Ushqimit Energjisë). |
| 2. Kodi i pozicionit: Kod vendodhje B-002, Kod grupi B, paragrafi 01, numër rendor 005 dhe specialitet LR 2477 |
| 3. Reparti Ushtarak Nr. 2006 (Qendra e Vëzhgimit Detar) në Forcën Detare |
| 4. Vendi: Plepa Durres |
| 5. Paga: 34.500 (Tridhjetë e kater mijë e peseqind) lekë |
| 6. Lloji i kontratës së punës: Kontratë me afat të pa caktuar |
| 7. Data e fillimit të aplikimit: 06.11.2019 |
| 8. Data e mbylljes së aplikimit: 21.11.2019 |
| 9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Komandës së Forcës Detare, brenda afatit të |

caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën:

Komanda e Forcës Detare Plepa Durrës

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [ëëë. mod.gov.al](http://eëë.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrajnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;

- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
dh) të mos ketë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil
- b. Arsimi : I Mesëm.
- c. Kualifikimi: Diplomën e shkollës së mesme të noterizuar ose në origjinal (përgjithshme ose profesionale për elekticist/elektroauto. Dëshmi profesioni për elekticist/elektroauto/motorrist.
- d. Trajnimi: Kurse dhe kualifikime të ndryshme civile dhe ushtarake për formimin e përgjithshëm dhe atë profesional.
- e. Eksperiencia në Punë: Eksperiencë pune si elekticist/elektroauto/motorrist.
- f. Gjuha e huaj: Preferohet anglisht.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Të jetë i/e aftë të bashkëpunojë në grup.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: -

13. Përshkrimi i punës:

- a. Detyrat kryesore:
 - Zbaton rregullat e procedurat për mirëmbajtjen e burimeve të ushqimit me energji dhe motogjeneratorëve të SIVHD-së dhe përgjigjet për aftësimin tekniko-profesional të tij.
 - Realizon mirëmbajtjen e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së.
 - Ndjek në vazhdimësi mirëmbajtjen e gatishmërinë e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së.
 - Harton projekt-nevojat për pajisje, pjesë këmbimi e materiale të tjera për mirëmbajtjen e gatishmërinë e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së për çdo PRT.
 - Ndjek detyrat që lidhen me mirëmbajtjen, riparimin dhe shërbimet teknike të Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së.
 - Përgatit analizat dhe nxjerr të dhënat e nevojshme për mirëmbajtjen e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së, për çdo PRT dhe raporton tek përgjegjësi i sektorit.
 - Analizon koston e mirëmbajtjes së Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji

të PRT-ve dhe bënë propozime për përmirësimin e tyre.

- Ndjek zbatimin e detyrave, urdhërave dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e gatishmërinë e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji të SIVHD-së .
 - Përgjigjet për kryerjen e mirëmbajtjes e riparimin e Motogjeneratorëve dhe Burimeve të Ushqimit me Energji në PRT-të e QVD-së.
 - Planizon, kontrollon dhe kryen, së bashku me grupin e specialistëve të mirëmbajtjes, shërbimet teknike të planifikuara për mirëmbajtje në të gjitha PRT-të.
 - Analizon difektet e avaritë e ndodhura në Motogjeneratorët dhe Burimet e Ushqimit me Energji të PRT-ve dhe i raporton ato tek eprorët.
 - Harton nevojat për mirëmbajtje e riparim dhe i paraqet ato te sektori i furnizimit.
 - Përgjigjet për sigurimin, mirëmbajtjen, kryerjen e shërbimeve teknike dhe eliminimin e difekteve të burimeve të ushqimit me energji (BUE) të gjitha pajisjeve të PRT-ve
 - Ndjek në mënyrë periodike orët e kryera nga motogjeneratorët e PRT-ve dhe mban evidenca të sakta për këtë qëllim.
 - Ndjek dhe kontrollon gjëndjen e baterive akumulatorë të motogjeneratorëve dhe APC-ve dhe merr masa për zëvendësimin e tyre sipas afatave të parashikuara.
 - Ndjek kompletimin e motogjeneratorëve me librezat përkatëse dhe kontrollon plotësimin e mbushjen e tyre sipas rubrikave përkatëse.
- b. Përgjegjësitë:
- Zbaton, rregullat e procedurat për mirëmbajtjen e burimeve të ushqimit energjisë, aftësimin e trupave të mirëmbajtjes BUE. Merr pjesë në mirëmbajtjen e aparaturave dhe teknikës së BUE. Realizon mirëmbajtjen e BUE.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
-

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerëimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
 - b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.
- **Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:
 - a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
 - b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
 - c. vlerësimin e trajnimeve;
 - d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;
 - Pikët totale të vlerëimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:
 - a. jetëshkrimi, 5 pikë;
 - b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
 - c. trajnimi, 5 pikë;
 - d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerëimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.